



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31158-07286-80-2018 Data e Regjistrimit : 06/12/2018
Numri i Vendimit: 80-2019-269 Data e Vendimit : 01/02/2019

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR:{...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 01/02/2019 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore ceshtjen civile qe i perket :

Padites {...}, I Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale

Objekti:Shpalljen e pavlefshmerise relative te pjesshme te aktit administrative, vendimit Nr. 133/13 prot., date 26.10.2017 te Bordit te Apelimeve te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, per shkak se eshte marre ne zbatim te gabuar te ligjit si dhe analizim te gabuar te rrethanave te faktit. 2. Ndryshimin e ketij vendimi, duke vendosur pranimin e plote te kundershimit te paragitur nga {...}, ndaj aplikimit kombetar Nr.AL/T/2016/133 per marken {...}(fjale &figure), si dhe refuzimin e regjistrimit te kesaj marke per te gjitha mallrat ge eshte kerkuar mbrojtja.

Baza Ligjore:Neni 17 (1) (b) si dhe nenet 11 (1) dhe 15 (1) (a) te ligjit Nr. 49/2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative” (i ndryshuar); neni 109(1)(d) te Kodit te Procedurave Administrative; neni 143 (2) (b) (c) te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 “Per Pronesine Industriale” (i ndryshuar).

VEREN :

Veren:

Se paditesi shoqeria {...}sh.p.k ka paraqitur para kesaj gjykate kerkespadine me objekt: 1. Shpalljen e pavlefshmerise relative te pjesshme te aktit administrative, vendimit Nr. 133/13 prot., date 26.10.2017 te Bordit te Apelimeve te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, per shkak se eshte marre ne zbatim te gabuar te ligjit si dhe analizim te gabuar te rrethanave te faktit. 2. Ndryshimin e ketij vendimi, duke vendosur pranimin e plote te kundershimit te paraqitur nga {...}, ndaj aplikimit kombetar Nr.AL/T/2016/133 per marken {...}(fjale &figure), si dhe refuzimin e regjistrimit te kesaj marke per te gjitha mallrat qe eshte kerkuar mbrojtja.

Nga shqyrtimi gjyqesor ka rezultuar se, shoqeria {...}sh.p.k ka per objekt te veprimtarise se saj: *Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen dhe marrjen pjese ne te gjitha aktivitetet qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, dhe ne veganti: Marrja persiper dhe ekzekutimi i gdo vepre teknike duke perfshire por pa u kufizuar ne sipermarrjen e ndertimeve te ndertesave te gdo lloji, veprave rrugore, hekurudhore, ujesjelles dhe kanalizime. Projektim dhe ndertim te veprave te ndryshme civile dhe industriale. Pjesemarrje ne tendera te kontraktuar brenda dhe jashte vendit. Tregtimi me pakice dhe shumice te produkteve dhe materialeve te ndertimit, duke perfshire te gjitha aktivitetet e importit, eksportit, aktivitet ndermjetesimi per realizimin e qellimit te plote te produkteve te permendura me siper, etj.* Ne date 10.11.2015, shoqeria {...}sh.p.k ka aplikuar kerkesen prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, per regjistrimin e markes se saj. Me certifikaten nr.756 prot date 18.05.2016, kjo drejtori ka bere regjistrimin e markes nr.16728, e vlefshme prej date 10.11.2015 deri ne date 10.11.2025.

Po keshtu, shoqeria {...} shpk ka aplikuar per regjistrim te markes se saj me emertimin "{...}", ne klasat 17, 19, 35, 36, 39, 40 te klasifikimit te Nises.

Ky aplikim eshte kundershtuar nga shoqeria {...}sh.p.k, me argumentin se krijon ngjashmeri me marken e saj te regjistruar me pare.

Me shkresen nr.133 prot date 16.12.2016, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale ka njoftuar palet e interesuara per pjesmarrje ne proceduren e kundershtuar.

Ne vijim, Bordi i Apelit i Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka marre vendimin Nr. 133/13 prot., date 26.10.2017, me te cilin ka vendosur:

- 1. Pranimin e kundershimit te markes se kundershtuar {...} per te gjitha mallrat dhe sherbimet te kerkuara te klasave 17, 19 dhe 37 te klasifikimit te Nises dhe refuzimin e regjistrimit te saj per keto mallra dhe sherbime.*
- 2. Pranimin e kundershimit te markes se kundershtuar {...} vetem per sherbimet e klasave 35 dhe 40 te klasifikimit te Nises, qe kane lidhje me materialet e ndertimit dhe dhe refuzimin e regjistrimit te saj per keto sherbime.*
- 3. Rrezimin e kundershimit te markes {...} per te gjitha sherbimet e klasave 36 dhe 39 te klasifikimit te Nises, qe nuk kane lidhje me materialet e ndertimit dhe vijimin e regjistrimit te saj per keto sherbime...*

Ne keto kushte, pala paditesi i eshte drejtuar gjykates duke pretenduar ne menyre te permbledhur se: - ne vendimin e pales se paditur, gjithashti konstatohet nje gabim material tek dy pikat e fundit te dispozitivit te vendimit, te cilat duken se vendosin per te njejten ceshtje por me formulime kontradiktore. Konkretisht, ne piken e parafundit (pika 3) eshte vendosur rrezimi i kundershimit per sherbimet e klasave 36 dhe 39, perjashto ato qe kane lidhje me materialet e ndertimit, kurse pika e fundit (pika 4) flet pikerisht per te

njejtin refuzim/rrezim por ketu nuk perjashtohen materialet e ndertimit. Dukshem jemi para nje gabimi

material qe DPPI duhet ta korrigoje. Megjithate, pavaresisht korrigjimit te mundshem te kesaj ceshtje, ne kundershtojme kete pjese te vendimit dhe sikur DPPI te mbaje piken 3 te vendimit. Arsyeya e vetme mbi te cilen Bordi i Apelimeve te DPPI mbeshtet vendimin e tij kur rrezon kundershkrimin tone eshte se sherbimet ne diskutim - per te cilat eshte vendosur refuzimi i kundershkrimit, nuk jane te ngjashme, dhe per rrjedhoje nuk ka mundesi per konfuzion. Vendimi i pales se paditur, pervecse nuk eshte i drejte - pasi sherbimet ne diskutim rezultojne te jene te ngjashme, ky vendim gjithashtu rrjedhoje e zbatimit te keq te ligjit material e me konkretisht nenit 143 (c) te ligjit Nr.9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" (te ndryshuar), dispozite materiale kjo qe parashikon kundershkrimin e nje marke dhe kur ajo aplikohet ne sherbime apo mallra te ndryshme. Vendimi i kontestuar (pjesa e kontestuar e tij) eshte dukshem i marre ne kundershkrim me nje dispozite materiale te ligjit, keshtu qe ne baze te nenit 109 (1) (d) te Kodit te Procedurave Administrative ai konsiderohet i paligjshem dhe duhet te shfuqizohet. -Marka e paditesit eshte perdorur gjeresisht ne treg dhe gezon statusin e nje marke te mirenjohur, e per pasoje gezon nje mbrojtje me te gjere, ku ka te drejte te kundershtojte dhe nje aplikim te mevonshme per mallra/sherbime te ndryshme [neni 143 (2) (c) e ligjit specifik]. Pala e paditur ne ne vendimin e saj certifikon statusin tone si marke e meparshme, sipas kuptimit te nenit 143 (5) (a) te ligjit specifik, ai gjithashtu i gjen markat ekstremisht te ngjashme vizualisht, fonetikiisht, konceptualish. Bordi, me te drejte, gjithashtu gjene shume ngjashmerime mes mallrat te klasave 17,19 te markes se kundershtuar me sherbimet e klases 37 te markes se meparshme, dhe pranon kundershkrimin tone per refuzimin e markes se kundershtuar ne klasat 17, 19, 37 dhe pjeserisht per klasat 35 dhe 40 te klasifikimit te Nices. Megjithate Bordi gabon kur rrezon kundershkrimin tone per sherbimet e klases 35 dhe 40, perjashto ato te lidhura me materialet e ndertimit, si per sherbimet e klasave 36 dhe 39. Sipas Bordit keto sherbime nuk jane aspak te ngjashme me ato te klases 37 te markes se meparshme. Sic eshte thene me lart, ky vleresim pervecse nuk eshte i drejte - pasi sherbimet ne diskutim rezultojne te jene te ngjashme, ai gjithashtu eshte rrjedhoje e zbatimit te keq te ligjit material e me konkretisht nenit 143 (c) te ligjit Nr.9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" (te ndryshuar), dispozite materiale kjo qe parashikon kundershkrimin e nje marke dhe kur ajo aplikohet ne sherbime te ndryshme. Nje marke nuk duhet te regjistrohet ose nese eshte regjistruar ajo duhet te cregjistrohet nese: "(b). marka e mevonshme eshte e njejte ose e ngjashme me marken e meparshme; aplikimi i mevonshem mbulon mallra dhe sherbime te njejta ose te ngjashme dhe, per shkak te ngjashmerive te markave dhe mallrave apo sherbimeve te mbuluara nga keto marka, ekziston mundesia per konfuzion tek publiku perkates, duke perfshire dhe mundesine e bashkelidhjes se markes me marken e meparshme." [neni 143 (2) (b) e ligjit specifik]. Ky eshte nje konkludim dhe i Bordit me te cilin ne biem dakort. Megjithate analiza e Bordit per konfuzion eshte e manget dhe e paplote, duke e cuar Bordin ne konkluzione te gabuara. Konkretisht Bordi nuk mban parasysh dhe faktore te tjere qe influencojne mundesine per konfuzion. Ceshtja e ngjashmerise mes mallrave/sherbimeve eshte adresuar gjeresisht nga Gjykata e Drejtesise se Bashkimit Europian (GJDBE) ne ceshtjen c-39/97 {...} v {...} Inc. [1998] OJ OHIM 12/98, ku gjykata percaktoi shprehimisht se: "*Kur krahesojme ngjashmerite mes mallrave dhe sherbimeve, duhen te mbahen parasysh te gjithe elementet perkates te lidhur me keto mallra apo sherbime. Keto elemente perfshijne midis te tjerash, natyren e tyre, qellimin, metoden e perdorimit, dhe nese ato jane ne konkurrence me njera-tjetren apo jane plotesuese te njera-tjetres*" (paragrafi 23). Te tjere faktore perfshijne kanalet e shperndarjes sidomos ato te dyqaneve te shitjes, publikun perkates dhe origjinen e zakonshme te mallrave". Gjithashtu praktika ka sanksionuar se mallrat dhe/ ose sherbimet mund te gjenden te ngjashme me shkalle te ndryshme (te uleta, mesatare ose te larta), ne varesi te faktoreve qe ata ndajne dhe peshes se dhene secilit prej tyre. Kjo shkalle ngjashmeri merret parasysh ne vleresimin e pergjithshem te mundesise per konfuzion ku tashme eshte sanksionuar se "nje shkalle e ulet e ngjashmerive mes mallrave/sherbimeve mund te tejkalohet nga nje shkalle e larte ngjashmerie mes

-Nga nje krahasim i kujdesshem i sherbimeve ne diskutim konstatohen se ato ndajne disa karakteristika te perbashkte cilat i bejne ato relativisht te ngjashme. Duke patur parasysh shkallen e larte qe markat/shenjat ne diskutim ndajne - sic dhe Bordi, me te drejte ka konkluduar, ngjashmeria dhe pse e paket gjendur mes mallrave, eshte e mjaftueshme per te konkluduar **se mundesia per konfuzion eshte prezent dhe markes se kundershuar duhet ti refuzohet mbrojtja per te gjitha sherbimet qe ajo ka aplikuar.**

Gjate procedures te mbajtur ne Bordin e Apelimeve depozituam prova dhe parashtruam fakte qe provuam perdorimin gjeresisht te markes tone ne Shqiperi. Theksi u vu ne vecanti tek prezantimet e markes ne panairte te ndryshme te ndertimit, si dhe ne promovime te ndryshme bere ne prezantimet e teknologjise se ndertimit. Gjithashtu shume figura publike, kane permendur marken {...} ne shume prononcimet e tyre publike si marke me standarte bashkekohore. Perpost kesaj, shume vepra publike si psh rruga Elbasan-Cerrik- Banje etj i eshte besuar kompanise paditese {...}. Te gjitha keto fakte jane mese te mjaftueshme per te permbushur kriteret e parashikuara nga neni 143 (5) (c) te ligjit specifik e per ta klasifikuara marken Asphalt Rubber si te mirenjohur ne Republikën e Shqiperise. E rrjedhimisht, marka kundershuese - ashtu sic dispozita e sipercituar parashikon, gezon te drejten te kundershutoje dhe nje aplikim apo marke te mevonshme dhe per mallra apo sherbime te ndryshme me ato per te cilat eshte regjistruar marka e meparshme. Por sic shihet Bordi ka vendosur ndryshe. Ai ka injoruar plotesisht kete fakt, kur bere keshtu nje shkelje te rende te nje dispozite materiale te ligjit, sic eshte neni 143 (2) (c) e ligjit specifik, dhe si i tille, ne baze te nenit 109 (1) (d) te Kodit te Procedurave Administrative ai konsiderohet i paligjshem (pjeserisht) edhe duhet te shfuqizohet. Personi i trete, ne menyre te permbledhur ka prapesuar se:-Nga faktet dhe rrethanat e mesiperme rezulton fare e qarte se perfaqesuesit e shoqerise Losha Construction, ne kushtet e keqbesimit, kane shfrytezuar informacionin per teknologjine dhe markat e grupit Rosi qe dispononin si rezultat i marredhenieve te punesimit dhe te sherbimit qe kane pasur dhe kane me kete shoqeri, dhe ne vijim, ne menyre te kunderligjshme, duke shkelur te gjitha parimet e mirebesimit dhe te drejtat e pronesise mbi markat tregtare, kane regjistruar ne Shqiperi marken {...}. Eshte me se e qarte se i gjithe informacioni qe kundershuesi ka pasur ne dispozicion, si pasoje e marredhenieve te punesimit dhe sherbimeve, eshte perdorur ne keqbesim, ne kundershitim te plote me nenin 173/b te Ligjit 9947/2008, i amenduar, ("Ligji 9947/2008"), i cili percakton regjistrimin ne keqbesim si nje nga arsyet e shfuqizimit te markes tregtare. I njeiti qendrim eshte mbajtur ne disa raste edhe nga Gjykata Europiane e Drejtesise (Vendimi date 11 Korrik 2013, ne ceshtjen T-321/10, GRUPPO SALINI / SALINI), ku anetaresia ne bordin drejtues te shoqerise kundrejt nje kontrate sherbimi eshte konsideruar si veprimtari ne keqbesim. Ne mungese te bazes ligjore per te marre ne shqyrtim ceshjen e keqbesimit, (referoju pikes IV. 1 te Vendimit 133/13), Bordi i Apelimit mori Vendimin nr. 133/13 prot. date 26.10.2017, i cili eshte objekti i ketij gjykimi, vendim ne te cilin nuk ka shqyrtuar pretendimet tona ne lidhje me keqbesimin ne regjistrimin e markes tregtare nga Losha Construction. Ne keto kushte, ne daten 25 Janar 2018, ne kuader te ndryshimeve te Ligjit 9947/2008, ne perputhje me nenin 173/1 (b) te Ligjit 9947/2008, te ndryshuar, i cili percakton regjistrimin ne keqbesim si nje nga arsyet e shfuqizimit te markes tregtare, i jemi drejtuar Dhomes se Shfuqizim/Zhvleresimeve prane DPPI me kerkesen tone nr. AL/2018-00637 per shfuqizimin e markes tregtare {...} (ALT/2015/756) me nr. regjistrimi 16728, si marke e regjistruar ne kushtet e keqbesimit.

-Ne lidhje me objektin e padise, pavlefshmerine e pjeshme te Vendimit nr. 133/13 prot. date 26.10.2017 te Bordit te Apelimeve, duke lene menjane pjesen e keqbesimit, e cila sic u shpjegua me lart eshte bere tashme objekt i nje shqyrtimi administrativ, jemi te mendimit se analiza e bere nga Bordi e Apelimit eshte e drejte dhe e mbeshtetur ne ligj. Me te drejte Bordi i Apelimit ka arritur ne perfundimin se te dyja markat kane ngjashmeri nga pikepamja vizuale, konceptuale dhe fonetike. Gjithsesi ne lidhje me

analizen nga pikepamja e ngjashmerise se mallrave, me te drejte Bordi i Apelimit ka arritur ne perfundimin se persa i perket klasave 36 dhe 39:

Klasa 36: Sherbime te sigurimeve; ceshtje financiare; ceshtje monetare; ceshtje te pronave te paluajtshme; transkaksionet monetare; sherbimet financiare; keshillimi dhe informimi financiar; financimi i blerjes.

Klasa 39:...'Transportimi; paketimi dhe magazinimi i mallrave; organizim i udhetimeve sherbime magazinimi; paketim i mallrave; shperndarja e pakove; sherbime logjistike ne sektorin e transports transport i dergesave; dergim porosish ne vendndodhjen e mallrave per qellime logjistike; informacion per transportin; informacion per magazinimin; organizim i sherbimeve te transports per njerez dhe mallra nepermjet tokes, ujit dhe mjeteve te ajrit; kryerja dhe organizimi i sherbimeve te transportit; sherbime korriere; organizim i transportit te mallrave, pasagjereve dhe/ose udhetareve nga toka dhe uji; organizimi dhe kryerja e shperndarjes se mallrave nepermjet postes; transportimi dhe shperndarja e mallrave nepermjet automjeteve; trenit, anijeve dhe avioneve.

Keto klasa jane krejtesisht te ndryshme nga sherbimet per te cilat eshte mbrojtur marka kundertshtuese, (ndertim, sherbime instalimi) dhe ne keto kushte nuk ekziston mundesia per konfuzion, ne kuptim te shkonjes "b" te pikes 2 te nenit 142 te Ligjit 9947/2008. Ne keto kushte Vendimi i kontestuar eshte i drejte, dhe si i tille duhet te lihet ne fuqi, duke rrezuar kerkese - padine e paraqitur nga pala paditese. Lidhur me bazueshmerine e kerkimeve te paditesit, gjykata i referohet ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", si dhe vendimit unifikues nr.3 date 29.03.2012 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte. Ne vendimin unifikues nr.3 date 29.03.2012 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, eshte arsyetuar se: *"Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte vleresojne se pergatitja dhe gjykimi e zgjidhja e geshtjes nuk mund te bazohet vetem mbi ate qe formalisht shkruhet ne pjesen hyrese te kerkesepadise e qe emertohen "objekti i padise" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarreveshjen merr ne shqyrtim pretendimet e paditesit te cilat parashtrohen ne kerkesepadi si dhe gjate ushtrimit te se drejtave qe rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 te K.Pr.C. objekti i padise dhe shkaku i saj nuk permbledhen domosdoshmerisht vetem ne pjesen hyrese te kerkesepadise. Gjykata ka detyrimin te vleresoje dhe te marre parasysh te gjitha permbajtjen e padise dhe te identifikoje kerkimet e paditesit, ne menyre qe te mund te jape nje vendim per to. Pala paditese ka te drejte te ngreje pretendime per mbrojtjen e te drejtave dhe interesave qe i njeh Kushtetuta apo ligji, ndersa gjykata, ne zbatim te parimit iura novit curia, analizon ligjerisht ne menyre te pavarur keto pretendime, pa u lidhur me percaktimin e paleve. Nese gjykata konstaton se pretendimet e paditesit, d.m.th. objekti i padise dhe shkaku i saj, gjejne mbrojtje ligjore atehere e pranon padine, ne rast te kundert padia rrezohet.*

Ne kendveshtrim te ketij vendimi unifikues, duke marre parasysh permbajtjen e kerkesepadise, gjykata identifikon kerkimin e pales paditese. Ne thelb kerkimi i pales paditese ka te beje shfuqizimin e pjesshem te aktit administrativ, objekt gjykimi, per shkak te paligjshmerise se tij.

Sic ka rezultuar, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesine Industriale ka bere regjistrimin e markes nr.16728, ne pronesi te pales paditese, e vlefshme prej date 10.11.2015 deri ne date 10.11.2025. Po keshtu, shoqeria {...} shpk (personi i trete) ka aplikuar per regjistrim te markes se saj me emertimin "{...}", ne klasat 17, 19, 35, 36, 39, 40 te klasifikimit te Nises. Ne zbatim te detyrimeve te sanksionuara te nenit 151 te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine industriale", Drejtoria e Pergjithshme e Pronesine Industriale ka bere publikimin e ketij aplikimi.

Konkretisht ne piken 1 te kesaj dispozite parashikohet se:

1. DPPI-ja publikon te dhenat e aplikimit qe ploteson te gjitha kerkesat e parashikuara ne nenet 150 dhe 150/a ne buletin e radhes.

2. *Te dhenat e aplikimit, qe botohen ne buletin e DPPM-se, parashikohen ne rregulloren perkatese.*

Ne baze te nenit 151/a te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine industriale", aplikimi i shoqerise {...} shpk (personi i trete) eshte kundershuar nga shoqeria {...} sh.p.k, me argumentin se krijon ngjashmeri me marken e saj te regjistruar me pare.

Me shkresen nr.133 prot date 16.12.2016, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesine Industriale ka njoftuar palet e interesuara per pjesmarrje ne proceduren e kundershuar. Ky njoftim eshte kryer ne perputhje me nenin 153 te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", ne te cilin percaktohet procedura e kundershimit.

Ne vijim, Bordi i Apelimit i Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale ka marre vendimin Nr. 133/13 prot., date 26.10.2017, me te cilin ka vendosur:

- 1. Pranimin e kundershimit te markes se kundershuar {...} per te gjitha mallrat dhe sherbimet te kerkuara te klasave 17, 19 dhe 37 te klasifikimit te Nises dhe refuzimin e regjistrimit te saj per keto mallra dhe sherbime.*
- 2. Pranimin e kundershimit te markes se kundershuar {...} vetem per sherbimet e klasave 35 dhe 40 te klasifikimit te Nises, qe kane lidhje me materialet e ndertimit dhe dhe refuzimin e regjistrimit te saj per keto sherbime.*
- 3. Rrezimin e kundershimit te markes {...} per te gjitha sherbimet e klasave 36 dhe 39 te klasifikimit te Nises, qe nuk kane lidhje me materialet e ndertimit dhe vijimin e regjistrimit te saj per keto sherbime...*

Sipas pikes 2 te nenit 17 te ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative": *2. Gjykata zgjidh mosmarrveshjet ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarrveshjen, pa u lidhur me percaktimin qe mund te propozojne palet. Nderkohe neni 37 i ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" percakton kufijte e shqyrtimit te geshtjes nga gjykata. Keshtu ne piken 1 te nenit 37 sanksionohet se gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ. Konkretisht ne piken 1 te kesaj dispozite parashikohet se: *1. Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ.**

Ne veshtrim te nenit 152 dhe 153 te Ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Per pronesine intelektuale" dhe Kreut XI te V.K.M-se nr.1706, date 29.12.2008 "Per miratimin e Rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit", Bordi i apelimit i DPPM-se ka marre ne shqyrtim kundershimitin e aplikimit per regjistrim te personit te trete, paraqitur nga shoqeria {...}sh.p.k. Per kete, me shkresen nr.133 prot date 16.12.2016, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesine Industriale ka njoftuar palet e interesuara per pjesmarrje ne proceduren e kundershuar. Keto te fundit kane paraqitur kundershimet e tyre prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale. Po keshtu Bordi e ka shqyrtuar kundershimitin brenda afatit ligjor dhe me pas ka marre vendimin, objekt gjykimi.

Nga teresia e kesaj veprimtarie administrative, gjykata vlereson se pala e paditur ka respektuar standartet e procesit te rregullt ligjor, te cilat nuk jane te kufizuara vetem ne procesin gjyqesor, por edhe ne ate me karakter administrativ (vendimi nr.7 dt,27.02.2012 i Gjykates Kushtetuese).

Sa me siper gjykata gmon se ne aspektin procedural, pala e paditur ka vepruar ne perputhje me proceduren e percaktuar ne ligj, dhe per rrjedhoje ka nxjerre nje akt te vlefshem nga pikepamja formale. Po keshtu vendimi Nr. 133/13 prot., date 26.10.2017 i Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesine Industriale, objekt gjykimi, eshte nxjerre ne perputhje me nenin 142 dhe 143 te ligjit Nr. 9947 date

07.07.2008 "Per Pronesine Industriale". Ne nenin 142 te

1. Nje shenje nuk regjistrohet si marke ose nese regjistrohet, mund te shfuqizohet kur:

a) nuk ka karakter dallues;

b) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve;

c) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe jane bere te zakonshem ne gjuhen e perditshme apo qe jane kthyer ne praktika tregtare;

g) perbehet nga forma ose vija, te imponuara nga vete natyra e mallrave apo e sherbimeve dhe/ose forma apo linja thelbesore, per te permbushur nje rezultat teknik;

d) perbehet nga forma, qe u japin mallrave nje vlere thelbesore;

dh) perbehet nga elemente, qe cenojne interesin publik ose qe bien ne kundersiztim me vlerat morale apo rendin publik;

e) perbehet nga elemente, qe kane prirje te gorientojne publikun per natyren, cilesine, origjinen gjeografike ose tregtare te mallrave dhe/ose sherbimeve, qe ato kane per qellim te dallojne;

e) perbehet nga tregues gjeografike, per vererat ose pijet alkoolike, qe nuk e kane origjinen gjeografike nga vendet, qe tregohen ne keta tregues, edhe nese tregohet origjina e vertete e produkteve, ose treguesit gjeografike jane perkthyer apo shoqeruar me shprehje te tilla, si "lloji" "tipi" "stili" "imitimi" ose shprehje te ngjashme;

f) shfuqizuar;

g) perbehet nga:

i) emra shtetesh (te plote ose te shkurtuar);

ii) emblema shtetere, medalje, urdhra nderi;

iii) vula dhe shenja zyrtare te miratuara nga vendi;

iv) emblemat e organizatave te njohura nderkombetare ose shkurtimet e tyre;

v) simbolet fetare;

vi) flamujt kombetare;

gj) perbehet nga elemente, qe bien ne kundersiztim me nenin 6 te Konventes se Parisit, perveg kur autoritetet kompetente kane autorizuar perdorimin e tyre. h) nuk perben marke, sipas nenit 140 te ketij ligji;

i) permban ose perbehet nga nje emertim origjine ose nje tregues gjeografik, me efekt ne territorin e Republikes se Shqiperise, nese kerkesa per regjistrimin e markes eshte dorezuar pas dates se dorezimit te kerkeses per regjistrimin e emertimit te origjines ose treguesit gjeografik dhe me qellim mbrojtjen e tyre, te parashikuar ne legjislacionin, ne baze te te cilit jane regjistruar ato dhe qe kane lidhje me te njejtin lloj produktesh.

2. Nje shenje nuk perjashtohet nga regjistrimi si marke, ne perputhje me shkronjat "a", "b" e "c", te pikes 1, te ketij neni, ne qofte se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues ne procesin e perdorimit perpara dates se aplikimit. Nje marke tregtare nuk mund te zhvleresohet per te njejtat arsye, nese, para dates se kerkeses per shfuqizim, per shkak te perdorimit te saj, ajo ka fituar karakter dallues.

Ndersa ne piken 2 te nenit 143 te ketij ligji parashikohet se:

2. Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur:

a) eshte e njejte me nje marke te meparshme dhe mallrat e sherbimet, per te cilat eshte aplikuar ose regjistruar ajo, jane identike me mallrat ose sherbimet, per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;

b) eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia

identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;

Nga intepretimi *ad contrario* qe i behet gemes b) te pikes 2 te nenit 143 te ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" rezulton se, nje marke mund te regjistrohet nese nuk eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te

meparshme, per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njellojshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme. Ne rastin konkret, Bordi i Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ka lejuar regjistrimin e markes "R Asphalt Rubber" per sherbimet e klasave 36 dhe 39 te klasifikimit te Nises. Keto sherbime per te cilat eshte lejuar regjistrimi i markes ne emer te personit te trete, nuk jane te njejta apo te ngjashme me sherbimet per te cilat eshte regjistruar marka e pales paditese. Pra veprimtaria administrative e pales se paditur gjen mbeshtetje ligjore ne nenin 142 dhe 143 te ligjit nr.9947/2008.

Persa mesiper, gjykata cmon se vendimi Nr. 133/13 prot., date 26.10.2017 i Bordit te Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, eshte nxjerre ne perputhje me ligjin nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale", dhe si i tille duhet lene ne fuqi.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kesaj ceshtje, gjykata arrin ne konkluzionin se padia e paraqitur prej paditesit duhet rrezuar si e pabazuar ne ligj dhe prova.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenet 40, 41,42 te ligjit nr. 49/2012 date 03.05.2012 "Per gjykatat administrative dhe

Per keto arsye

Baza Ligjore:.

VENDOSI:

Vendosi: V E N D O S I

- Rrezimin e padise.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.
- U shpall sot me date 01.02.2019, Tirane.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:
{...}

